



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA

KOSOVA CUMHURIYETI

Komuna e Prizrenit * Opština Prizren

Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës Predsednik Opštine

Belediye Baškani

01

Nr.

126/25 Dt. 11.02.2025



HELVETAS

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

Projektit për Decentralizim dhe Mbështetje Komunave (DEMOS), i zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation i përfaqësuar nga Menaxheri i projektit (në vijim të referuar si “Projekti DEMOS”),

dhe

Komunës së Prizrenit, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës (në vijim të referuar si “Komuna”),

Qëllimi dhe fushëveprimi

Ky Memorandum Bashkëpunimi (Memorandum) ndërmjet Projektit DEMOS dhe Komunës së Prizrenit është lidhur me qëllim të bashkëpunimit për përmirësim të qeverisjes pjesëmarrëse dhe të sigurimit të angazhimit kuptimplotë të qytetarëve në procesin e planifikimit të hershëm buxhetor komunal.

Fusha e veprimit të këtij Memorandumi përfshin sigurimin e mbështetjes teknike dhe fuqizimin e kapaciteteve nga Projekti DEMOS për të mbështetur Komunën në arritjen e këtyre objektivave, së bashku me angazhimet e Komunës për të zbatuar masat specifike të përshkruara në këtë Memorandum.

Rolet dhe përgjegjësítë

Përgjegjësítë e Projektit DEMOS

- Mbështetja e Komunës në analizimin dhe paraqitjen transparente të buxheteve të disponueshme për konsultim me qytetarët,
- Lehtësimi i përgatitjes së materialeve dhe prezantimeve për dëgjimet buxhetore rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) dhe atyre për planifikim buxhetor vjetor.
- Ofrimi i trajnimeve dhe fuqizimi i kapaciteteve të përshtatura për anëtarët e grupit punues përgjegjës për organizimin e dëgjimeve buxhetore, me theks në:
 - Përcaktimin e qartë të roleve dhe përgjegjësive të tyre,
 - Evidentimin dhe raportimin adekuat të të gjithë procesit të konsultimit publik me qytetarët,
 - Vlerësimin, prioritizimin dhe kategorizimin e kërkesave të qytetarëve,



Co-funded by
the European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige



HELVETAS

- Sigurimin e përputhshmërisë së planifikimit buxhetor me prioritetet komunale, kufizimet buxhetore dhe përputhjen me Udhëzimin Administrativ (UA) për Administratë të Hapur¹.
- Mbështetja e Komunës në përdorimin e platformës së konsultimeve publike si mjet për plasimin transparent të informacionit buxhetor dhe marrjes së kontributit të qyteterëve, dhe
- Mbështetja e Komunës në shfrytëzimin e bazave të dhënave të grupeve të interesit për të rritur pjesëmarrjen qytetare në dëgjime buxhetore, me theks të veçantë në përfshirjen e grave, personave me aftësi të kufizuara, rinisë, banorëve nga viset rurale, dhe komuniteteve jo-shumicë.

Përgjegjësitet e Komunës

- Planifikimi i hershëm buxhetor duke aplikuar Udhëzuesin² e zhvilluar nga Projekti DEMOS,
- Të përbajturit me komponentë të tjerë të Udhëzuesit që synojnë përmirësimin e planifikimit, përfshirjes dhe përgjegjshmërisë së përgjithshme të dëgjimeve buxhetore,
- Nxjerra dhe miratimi i vendimit për themelimin e grupit punues përgjegjës për dëgjime buxhetore,
- Përcaktimi i qartë i roleve dhe përgjegjësive të secilit anëtar të grupit punues, duke përfshirë drejtoritë apo njësitë që përfaqësojnë dhe funksionet që ushtrojnë,
- Sigurimi i zbatimit të dispozitave të UA-së për Administratë të hapur, veçanërisht lidhur me kompetencat vendimmarrëse të anëtarëve të grupit të punës gjatë organizimit të dëgjimeve buxhetore, si dhe evidentimit, shqyrtimit dhe përgjigjes ndaj kërkesave të qytetarëve që pranojnë gjatë dëgjimeve buxhetore dhe procese të tjera konsultative, dhe
- Caktimi i një pike kontakti në kuadër të komunës për të trajtuar të gjitha çështjet që lidhen me këtë Memorandum, duke përfshirë raportimin dhe komunikimin me Projektin DEMOS dhe kërkesat që mund të dalin nga ky bashkëpunim.

Përgjegjësitet e përbashkëta

Të dyja palët bien dakord që të:

- Respektojnë parimet e transparencës, përgjegjshmërisë dhe përfshirjes në zbatimin e të gjitha aktiviteteve sipas këtij Memorandumi,
- Veprojnë me mirëbesim për të arritur qëllimet e këtij Memorandumi, dhe

¹ Udhëzim Administrativ (MAPL) NR. 04/2023 për administratë të hapura në Komuna

² Udhëzues për Planifikimin, Organizimin, Fasilitimin dhe Veprimet Përcjellëse të Dëgjimeve Buxhetore në Komuna, Maj 2024, Projekti DEMOS, Helvetas



Co-funded by
the European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige



HELVETAS

- Rishikojnë në baza të rregullta progresin e arritur dhe adresojnë çdo sfidë që mund të paraqitet gjatë zbatimit.

Kohëzgjatja

Ky Memorandum Bashkëpunimi është i vlefshëm nga data e nënshkrimit deri më 31.12.2025, përveç nëse përfundohet më herët me marrëveshje të përbashkët. Secila palë mund ta përfundojë këtë Memorandum me një njoftim paraprak me shkrim në një afat prej 30 ditësh.

Nënskrimet

Duke nënshkruar më poshtë, palët pranojnë kuptimin dhe pajtimin e tyre me kushtet e këtij Memorandumi.

Për Projektin DEMOS

Ertan Munoglu

Drilon Shala

Data

11.02.2025

Për Komunën

Kryetar i Komunës

Data 11.02.2025



Co-funded by
the European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige